

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
 ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr/Br. 984/20
 Datë/Datum. 20.11.20

PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA SUHAREKË**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr ¹ i prokurimit	624-20-4571-5-1-1
Nr i brendshëm	624-020-079-511

Sa i përket tenderit për: **Ndërtimi i shtëpisë së kulturës Ukë Bytyqi -Faza e dytë.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Ada Consulting Goup SH.P.K & Krapicom SH.P.K
 (Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Prishtine
 (Adresa)

Prishtine
 (Vendi)

10000
 (Kodi postar)

+383 44 506 206
 (Numri Telefonit)

N/A
 (Numri i Faks-it)

Faik Krapic-Përfaqësues i konzorciumit
 (Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Ada.es.group@gmail.com
krapicom@yahoo.com
 (Adresa elektronike)

20.11.2020
 (Data e parashtrimit të ankesës)


 (Nënshkrimi dhe vula)




¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtoj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vulë)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 01.09.2020
Procesverbal i hapjes së tenderit: 22.09.2020
Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues: 02.11.2020
Kërkesa për rishqyrtim dt.06.11.2020
Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim me dt:11.11.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e më tutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐



6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 64 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar ne me dt. 02.11.2020 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së ku është rekomanduar për kontratë "EUROING" SH.P.K., ndërsa neve na ka shpallur si tenderues të eliminuar me arsyetimin se "I mungon qarkullimi me kontrata 60% liderit të grupit, inxhinieri I infrastrukturës rrugore nuk e ka përvojën 3 vjeçare pas diplomimit, kamioni me kran I tipit Volvo Fl 108x2 me numër të targave 01-825-MS nuk e ka gjatësinë prej 25m sipas njësisë së kërkesës por është 20.4m

Ju sqarojmë se arsyet e AK-së për eliminimin tonë janë të pa bazuara dhe nuk qëndrojnë për arsyet si në vijim:

Në lidhje me arsyen e parë të AK-së ku e ka cekur se liderit të grupit i mungon qarkullimi me kontrata 60%, ju sqarojmë se ky arsyetim i AK-së është i gjithi i pa bazuar pasi që liderit i grupit pra ADA CONSULTING GROUP SH.P.K., jo vetëm që e përmbush kërkesën për qarkullim të kontratave, mirëpo edhe e kalon vlerën e përcaktuar nga AK-ja. Gjithashtu ne vetëm që të ja lehtësojmë punën e AK-së i kemi prezantuar disa prej faturave të cilat vlejnë dhe tregojnë qartë vlerën e punëve që janë kryer brenda tri viteve të fundit.

Pra pasi që kemi kontrata të cilat janë të nënshkruara në vitin 2015 ose 2016, ne për vetëm për të ia lehtësuar AK-së punën i kemi nxjerrur vlerat për të cilat kemi kryer punë brenda tri viteve të fundit. Mirëpo edhe pse ne jemi munduar të ju lehtësojmë punën AK-së, përsëri AK-ja e ka cekur se lideri i grupit nuk e përmbush kërkesën si më lartë, andaj ne jemi të habitur me këtë veprim të AK-së, pasi që me anë të këtij veprimi po krijohet përshtypja se AK-ja nuk i ka analizuar mirë kontratat të cilat i kemi prezantuar në ofertë, veprim ky që tregon qartë jo seriozitetin e AK-së në lidhje me ekzaminimin dhe vlerësimin e ofertës tonë, pasi që vetëm nëse analizohen sipërfaqësisht shihet qartë se lideri i grupit e plotëson kërkesën në lidhje me vlerën e kontratave gjatë tri viteve të fundit, mirëpo nëse analizohen mirë kontratat e paraqitura nga ne shihet qartë se ne jo vetëm që e përmbushim këtë kërkesë por edhe e tejkalojmë vlerën e kërkuar.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se ne e përmbushim kërkesën e lartcekur dhe se pretendimi i AK-së nuk qëndron. Ne edhe një herë sa për korrektësi po ju **bashkangjesim listën e kontratave** dhe kërkojmë nga ana juaj që ta detyroni AK ti analizoj edhe një herë dhe të merr një vendim sa më meritore në lidhje me kontratat e prezantuara nga ne, pasi që siç e cekëm më lartë ne e përmbushim kërkesën e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Sa i përket arsytimit të dytë të AK-së në lidhje me eliminimin tonë ku e ka cekur se inxhinieri i infrastrukturës rrugore nuk e ka përvojën 3 vjeçare pas diplomimit, ju sqarojmë se edhe ky pretendim i AK-së është i pa bazuar për faktin se ne e plotësojmë kërkesën e FDT-së dhe i kemi ofruar dëshmitë konform kërkesës së FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. Në diplomën të cilën e kemi prezantuar në lidhje me inxhinierin e lartpërmendur, shihet qartë data e diplomimit 26.06.2015, pra nga dëshmitë e ofruara nga ne është më se e qartë se ne e përmbushim kërkesën e lartcekur të FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, andaj kërkojmë nga ju që të detyroni AK që të analizoj edhe një herë dëshmitë e ofruara nga ne në lidhje me përvojën e inxhinierit.

Gjithashtu ne si kompani serioze edhe pse i kemi ofruar dëshmitë e kërkuara në FDT dhe tek njoftimi për kontratë, dëshmi të cilat nuk janë analizuar në tërësi nga ana e AK-së, në lidhje me inxhinierin e lartcekur, ne po ju bashkangjesim edhe një dëshmi tjetër vetëm që ju të bindeni se ne e përmbushim kërkesën e lartcekur. Pra inxhinieri i prezantuar nga ne si dëshmi se e përmbush kërkesën e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë na ka ofruar trustin, e cila është dëshmi e qartë që tregon saktë se ku ka punuar inxhinieri i prezantuar nga ne dhe tregon qartë se ne e përmbushim kërkesën në lidhje me përvojën e inxhinierit.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se ne si OE i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, andaj pretendimi i lartpërmendur nga ana e AK-së për eliminimin tonë nuk qëndron dhe është i gjithi i pa bazuar. **(Bashkangjitur keni dëshminë e Trustit për inxhinierin e lartcekur).**

Në lidhje me arsyen e tretë të AK-së ku e ka cekur se kamioni me kran i tipit Volvo FI 108x2 me numër te targave 01-825-MS nuk e ka gjatësinë prej 25m sipas njësisë se kërkesës por është 20.4m, ju sqarojmë se edhe ky arsyetim i AK-së është i pa bazuar dhe nuk qëndron për faktin se ne në ofertën tonë i kemi prezantuar në detaje dëshmitë në lidhje me kamionin e lartcekur ku shihet qartë se kamioni me kran i prezantuar nga ne është konform kërkesës së FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. Mirëpo nga ky veprim i po shihet qartë jo serioziteti i AK-së në lidhje me ekzaminimin dhe vlerësimin e ofertës tonë ku edhe pse ne e kemi sqaruar në detaje gjatësinë e kamionit ku shihet qartë se kamioni i ofruar nga ne është 25.8 metra pasi që siç e dijmë minimumi ka qenë 25 metra, andaj kamioni me kran është konform kërkesës së FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Pra nëse analizohet oferta jonë tek dëshmitë të cilat i kemi prezantuar shihet qartë se si e kemi sqaruar secilën pjesë të gjatësisë së kranit, andaj është për tu habitur fakti se si e ka llogaritur AK-ja gjatësinë e kranit ku e ka theksuar se kranit është vetëm 20.4m, pasi që nga dëshmitë e prezantuara nga ne shihet qartë se ne e përmbushim kërkesën e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë në lidhje me kamionin me kran.

Për të qenë sa më korrekt ne e kemi bërë vizatimin e kranit për të ju sqaruar sa më qartë se ne e përmbushim kërkesën në lidhje me kamionin me kran. **(Bashkangjitur keni vizatimin e kranit të detajizuar për leximin e gjatësisë së kranit).**

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se arsyet e AK-së për eliminimin tonë nuk qëndrojnë për faktin se ne i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë dhe njëkohësisht jemi OE më i lirë se OE i rekomanduar për kontratë për **283,070.59 €**, dhe gjithashtu jemi më i lirë së të gjithë OE ofertues në këtë aktivitet të prokurimit.

Andaj kërkojmë nga ju që ta detyroni AK ta rishikoj edhe një herë ofertën tonë ta analizoj në tërësi dhe në fund të bëj vlerësimin e saj konform kërkesave të tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Gjithashtu nëse AK-ja ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me kërkesat e lartpërmendura dhe dëshmitë të cilat i kemi prezantuar ne, atëherë ka mundur që në bazë të dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së të kërkoj sqarime shtesë nga ne dhe jo automatikisht të na eliminoj, mirëpo që nuk i ka përdorur fare dispozitat e lartcekura ku shihet qartë diskriminimi që po i bëhet kompanisë tonë si OE i përgjegjshëm, pasi që nga ana AK-së po përdoren standarde të dyfishta pasi që disa kompanive ofertuese ju ka kërkuar sqarime shtesë në lidhje me stafin duke specifikuar OE të rekomanduar për kontratë ku në lidhje me inxhinierin e infrastrukturës ka kërkuar sqarime shtesë lidhur me përvojën e tij, ndërsa për ne nuk ka kërkuar fare sqarime që tregon qartë diskriminimin ndaj kompanisë tonë dhe një herit favorizimin e OE të rekomanduar për kontratë.

Në lidhje me OE të rekomanduar për kontratë ju sqarojmë se AK-ja e ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim:

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë përkatësisht kërkesat teknike dhe profesionale ku kërkesë ka qenë *"Kërkesa 8- Inxhinier ose master i diplomuar i Ndërtimtarisë drejtimi infrastrukturë rrugore, se paku me 3 vite përvojë pune pas diplomimit"*, ndërsa si dëshmi dokumentarë është kërkuar *"Kontratat e punës ose marrëveshjet me inxhinieret, Diplomat e NOTERIZUAR dhe CV, Diplomat te cilat nuk janë te Republikës se Kosovës duhet te jenë të nostrifikuara nga MASHT - Prishtine dëshmi mbi përvojën e punës – referenca përkatëse për punë të ngjashme."*

OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur pasi që Inxhinierin e Infrastrukturës të cilin e ka prezentuar OE i rekomanduar për kontratë në CV e tij, shihet qartë se nuk e përmbush kërkesën e lartcekur sepse i mungon përvoja 3 vjeçare pas diplomimit si inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë- Infrastrukturës. Pra në CV e inxhinierit të lartcekur shihet qartë se ka vetëm 2 vite përvojë pas diplomimit në drejtimin Infrastrukturë, ndërsa përvoja tjetër e prezantuar për inxhinierin është përvojë para diplomimit si Inxhinier i Infrastrukturës. Andaj CV e këtij inxhinieri nuk i plotëson kërkesat e FDT-së, pasi që kërkesa ka qenë shumë e qartë pra së paku 3 vite përvojë pune dhe jo 2 siç e ka prezantuar OE i rekomanduar për kontratë inxhinierin.

Gjithashtu OE të rekomanduar për kontratë i mungojnë edhe referencat për Inxhinier e lartcekur, andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura AK-ja është dashur ta eliminoj nga ky aktivitet i prokurimit dhe jo ta rekomandoj për kontratë pasi që po shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se tek Deklarata nën Betim, shihet qartë se nuk është e nënshkruar nga pronari apo ndonjë përfaqësues i autorizuar. Mirëpo është e nënshkruar nga një person i cili nuk posedon autorizim të noterizuar për përfaqësim të kompanisë, andaj edhe është dashur të shpallet i papërgjegjshëm ky OE dhe jo të rekomandohet për kontratë, pasi që nuk mund të nënshkruhet deklarata nën betim nga një person i cili nuk është i autorizuar për përfaqësimin e kompanisë. Duke ju referuar certifikatës së biznesit Mefail Gashi figuron të jetë pronar, drejtor dhe person i autorizuar i kompanisë, andaj kushdo qoftë personi tjetër që nënshkruan në emër të tij duhet të jetë person i autorizuar nga drejtori i kompanisë në këtë rast, andaj është dashur të shpallet i papërgjegjshëm.

Se deklarata nën betim nuk është e nënshkruar nga pronari e vërteton fakti se në gjatë analizimit të dokumenteve të OE të rekomanduar për kontratë tek CV e stafit shihet qartë nënshkrimi i Astrit Gashit i cili figuron edhe tek deklarata nën betim, ndërsa po aty shihet edhe nënshkrimi i pronarit Mefail Gashi në CV e tij i cili nënshkrim nuk përputhet me nënshkrimin e deklaratës nën betim.

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se lista e punëtorëve dhe kontratat e stafit profesional dhe teknik nuk janë të nënshkruara nga drejtori i kompanisë Mufail Gashi, mirëpo nga një person i pa autorizuar, andaj duhet të shpallet i papërgjegjshëm pasi që nuk është prezantuar asnjë autorizim për përfaqësim të kompanisë nga personi që i ka nënshkruar kontratat dhe listën e stafit teknik dhe punëtorëve. Fakti se pretendimi ynë është i bazuar e vërteton edhe nënshkrimi tek CV-ja e Mufail Gashit i cili nuk përputhet fare me nënshkrimet e kontratave dhe listës së stafit.

Gjithashtu edhe CV-ja e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë në lidhje me inxhinierin e infrastrukturë Defrim Kabashi, në dyshojmë se nënshkrimi i CV-së dhe kontratës nuk përputhet me nënshkrimin e deklaratës nën betim andaj në dyshojmë se nuk është nënshkrimi i inxhinierit të lartcekur, andaj kërkojmë nga ju që të detyroni AK të vërtetoj se a është apo jo pretendimi ynë i bazuar. Po ashtu kontrata e lidhur me OE të rekomanduar për kontratë dhe inxhinierit nuk është nënshkruar nga një person i autorizuar.

Gjithashtu edhe inxhinieri i hidroteknikës Qamil Shala i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë tek CV e prezantuar shkruan se nga viti 2010 edhe me tutje vazhdon të punojë të Hidroing DK, ndërsa ka ofruar një letër referencë nga një kompani tjetër në të cilën shkruan se është ka qenë pjesë e kompanisë Diarko pa specifikuar ndonjë datë se kur ka filluar punën në atë kompani apo është ende në atë kompani pasi që letër referenca është e paqartë sepse shkruar është ka qenë, andaj duhet të shpallet i papërgjegjshëm.

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se tek lista e mjeteve e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë shihet qartë se nuk është e nënshkruar nga drejtori Mefail Gashi, mirëpo është e nënshkruar nga një person i pa autorizuar.



Po ashtu OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij ka prezantuar kamionin kiper dy dyer me targa 639-KS-299 i cili është me regjistrim të skaduar, andaj shihet qartë se nuk e plotëson kërkesën në lidhje me mjetet e kërkuara.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se marrëveshja për shfrytëzim të mjeteve të cilën e ka prezantuar OE i rekomanduar për kontratë është e lidhur me një OE i cili është njëkohësisht edhe ofertues në këtë aktivitet të prokurimit pra me kompaninë ISEFERI SH.P.K. Andaj është absurd fakti që dy OE të ofertojnë me të njëjtat paisje, për të njëjtin aktivitet të prokurimit. Andaj OE i rekomanduar për kontratë është dashur të shpallet i papërgjegjshëm dhe jo të rekomandohet për kontratë.

Gjithashtu edhe marrëveshja për marrjen e mjeteve me qira nuk është e nënshkruar nga drejtori i kompanisë, por nga një person i pa autorizuar, andaj shihet qartë se ky OE është i papërgjegjshëm edhe në lidhje me mjetet e punës të kërkuara në FDT dhe tek njoftimi për kontratë.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartpërmendura shihet qartë se ne jemi diskriminuar në këtë aktivitet të prokurimit pasi që edhe pse i përmbushim të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë dhe gjithashtu jemi OE më i lirë se OE i rekomanduar për kontratë për 283,070.59 € dhe jemi më të lirë se të gjithë OE tjerë ofertues.

Ne me dt. 11.11.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete dhe ligjore në pretendimet tona ankimore.

Në lidhje me arsyen e AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim, ju sqarojmë se ky arsyetim është i pa bazuar pasi që AK-ja nuk i ka shqyrtuar fare pretendimet tona ankimore, duke i vërtetuar edhe më shumë këto pretendime pasi që nëse pretendimet tona ankimore nuk do të ishin të qëndrueshme, atëherë AK-ja do të ofronte dëshmi se pretendimet tona nuk qëndrojnë, mirëpo që një veprim të tillë nuk e ka bërë.

Pasi që pretendimet tona ankimore nuk janë shqyrtuar fare nga ana e AK-së kërkojmë nga ju që të detyroni AK që ti vërtetojë pretendimet tona ankimore se a janë apo jo të bazuara, duke i dëshmuar me fakte dhe dëshmi konkrete pretendimet tona ankimore.

Andaj përderisa AK-ja nuk i ka shqyrtuar fare pretendimet tona ankimore, ne ndihemi të diskriminuar nga ana e AK-së sepse është rekomanduar për kontratë OE i cili është i papërgjegjshëm ndërsa ne jemi tenderues i përgjegjshëm dhe ashtu është dashur të shpallemi nga ana e AK-së, dhe gjithashtu jemi OE më i lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse e ka favorizuar operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë duke e rekomanduar për kontratë edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa neve na ka diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha



kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë dhe njëkohësisht jemi OE me çmim më të lirë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 6 të LPP-së, sepse janë të obliguar që të sigurohen që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, pasi që ne jemi më të lirë se OE i rekomanduar për kontratë në vlerë prej 283,070.59 €, dhe gjithashtu jemi më të lirë se OE e tjerë ofertues.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

V E N D I M

APROVOHET, ankesa e OE "Ada Consulting Goup & Krapic Com Shpk" si e bazuar
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM**,

DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përkrahja mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjithi kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.

